



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK-ja (në tekstin e mëtejshëm) në seancën së 87-të, të mbajtur më 01.06.2023, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-8483/1 të datës 28.09.2022 me pretendime për punë të paligjshme të personave zyrtar në -----, **HIDHET POSHT.**

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave nuk ka elemente për veprim kompetent.

Lënda me numër 12-8483/1 të datës 28.09.2022 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur më 28.09.2022 është dorëzuar denoncim me pretendim për punë të paligjshme të personave zyrtar në ----- dhe është formuar lënda me numër 12-8483/1 të datës 28.09.2022.

Në denoncim, parashtruesi thekson se nëpërmjet firmës së tij ----- që nga viti 2010 ka pasur një marrëveshje bashkëpunimi me -----, e cila është ndërprerë në mënyrë të njëanshme nga personi ----- transportuesi i ----- për produktet e -----, pasi djali i tij u bë menaxher i saj, dhe gjatë periudhës kur ata ishin në abonim në -----.

Tregohet se në të njëjtën ditë transportuesi për në ----- nuk ka dorëzuar 3600 rrënjë rrushi në vlerë prej 114000 denarë të cilat tashmë i ishin rezervuar në llogarinë e tyre nga magazinieri në Shkup. E gjithë kjo tregon për funksionimin e paligjshëm dhe mos mbajtjen e evidencës së xhiro llogarive dhe bashkëpunëtorëve. Po ashtu, është vënë në dukje "shantazh" nga personi i lartpërmendur dhe ----- të cilët kanë kërkuar pagesën e borxhit të pretenduar prej 300.000 denarë për vazhdimin e biznesit për të cilin thuhet se ka angazhuar një avokat dhe një

vlërësues për të verifikuar gjendjen faktike. parashtruesi thekson se kjo vërtetoi dyshimet e tij se kontabiliteti i dyfishtë është kryer përmes ----- – ndërmjetësuesit të personit juridik ndërmjet -- ----- dhe bashkëpunëtorët, dhe asnjë nga bashkëpunëtorët nuk kishte njohuri në të dhënat e ----- edhe pse ata duhej të konfirmonin numrin e artikujve dhe parave të gatshme. Gjithashtu nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se kërkuesi për veprimet e mësipërme ndaj personave të përmendur dhe ----- ka bërë kallëzim penal për evazion fiskal në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Duke vlerësuar pretendimet nga denoncimi, personat të cilëve u referohen pretendimet si dhe periudhën kur kanë ndodhur ngjarjet, KSHPK-ja vlerësoi se nuk ka elemente për veprime të mëtejshme për faktin se personat nuk janë zyrtarë në përputhje me nenin 8 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe autoritetet tjera veprojnë për pretendimet në fjalë pas së cilës vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Dorëzuar:

- Parashtruesi i denoncimit

Përgatiti: B.K.SH

Miratoi: K.N anëtar i KSHPK-së

**KOMISIONI SHETËROR PËR  
PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT  
Nënkryetar,  
Katica Nikolovska**